



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 543/1 Prot.

Vlorë më, 10 . 03 .2023

VENDIM

Nr. 10, datë 10.03.2023

PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES SË PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER
PROFESIONAL "UDHËRRËFYES TURISTIK PËR RAJONIN E JUGUT"

Në mbështetje të nenit 38, pika 1, shkronja d të Ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 19, pika 1, gërma dh, të Statutit të Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë, Udhëzimit nr.1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionit dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen dhe bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë", si dhe referuar propozimit të Zv/Rektorit Akademik ardhur e shkresën nr.531/2 prot, datë 09.03.2023 Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 10.03.2023

VENDOSI:

1. Të miratojë Rregulloren e programit të studimit me karakter profesional "Udhërrëfyes turistik për rajonin e jugut".
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Departamenti i Gjuhëve të Huaja, Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë, si dhe Zëvendësrektorit Akademik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof.Dr. Roland ZISI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK**

**RREGULLORE E PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL:
“Udhërrëfyes turistik për rajonin e jugut”**

Kjo rregullore është hartuar mbështetur dhe në zbatim të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në udhëzimin nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, Statutin dhe Rregulloren e Universitetit “Ismael Qemali”, Vlorë.

Neni 1

Emërtimi dhe statusi i programit

1. Programi i studimit njëvjeçar me karakter profesional: “Udhërrëfyes turistik për rajonin e jugut” ofrohet nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja, Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë, në koordinim të veprimtarive formuese, edhe me njësitë e tjera të këtij fakulteti dhe të Fakultetit të Shkencave Teknike. Ky program studimi është program me karakter profesional, i cili ofrohet në një vit akademik, në përfundim të të cilit studenti grumbullon 60 kredite (ECTs) dhe në përfundim lëshohet “Certifikatë profesionale”: “Udhërrëfyes turistik për rajonin e jugut”. Përveç njësive bazë dhe kryesore, programi do të realizohet edhe me mbështetjen e entiteve shtetërore dhe private që kanë nevojë për personel të kualifikuar dhe të pajisur me shprehitë përkatëse.

Neni 2

Objektivat formues të programit

1. Ky program formon specialistë në fushën e turizmit, të aftë për të punuar si udhërrëfyes turistikë, të pajisur me njohuri praktike e teorike, me njohuri të mirëfillta e të plota rreth gjeografisë, relievit, kontekstit historik e kulturor, trashëgimisë kulturore, etnografisë së trevave në rajonin e jugut.
2. Mbi të gjitha, ky program synon të aftësojë studentët e këtij programi me shprehje të mira gjuhësore, në gjuhën angleze dhe një gjuhë tjetër të dytë (italisht/gjermanisht/spanjisht/frëngjisht), si dhe t'i pajisë ata me kompetencën ndërkulturore dhe aftësi të larta komunikuese.
3. Ky program synon përgatitjen e specialistëve të aftë të kryejnë detyrat e udhërrëfyesit turistik, si të punësuar apo të vetëpunësuar për të ofruar shërbime që lidhen me shoqërimin e grupeve turistike, të pajisur me njohuri e etikë profesionale, shprehje të mira gjuhësore, në gjuhën angleze dhe një gjuhë tjetër të dytë, kompetencë ndërkulturore dhe aftësi të larta komunikuese, për ofrimin e shërbimeve cilësore udhërrëfyese në strukturat turistike e akomoduese në institucionale publike dhe private.
5. Nisur nga këto synime, objektivat formues të programit janë:





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE SENATI AKADEMIK

- a) Pajisja me njohuri të përgjithshme rreth historisë, gjeografisë, arkeologjisë dhe trashëgimisë dhe pasurive kulturore e natyrore të rajonit të jugut të Shqipërisë.
- b) Formim profesional, i plotë e bashkëkohor në teknikat e udhërrëfimit, në zbatimin e kodit të sjelljes dhe etikës personale, në shoqërimin e turistit dhe të grupeve turistike në lëvizje, në hartimin e itinerareve turistike etj.
- c) Aftësi për të komunikuar në dy gjuhë të huaja (anglisht dhe italisht/frengjisht/spanjisht/gjermanisht).
- d) Kompetencë ndërkulturore e aftësi komunikuese si thelbësore në ndërveprimin me të huajt dhe turistët në veçanti.

Neni 3

Disiplinat dhe veprimtaritë formuese të programit sipas krediteve

1. Kurrikula e programit të studimit njëvjeçar me karakter profesional në "Udhërrëfyes turistik për rajonin e jugut" organizohet në:
 - a. Lëndë bazë;
 - b. Lëndë karakterizuese;
 - c. Lëndë ndërdisiplinore/ integruese;
 - d. Lëndë plotësuese;
 - e. Detyrime përmbyllëse.
2. Kurset/lëndët në program dallohen nga emërtimi, kodi dhe numri i krediteve. Kodi përcakton këta elemente: gjuhën në të cilën zhvillohet kursi ose fushën e studimit së cilës i përket dhe vitin/nivelin e studimit në të cilin ofrohet. Kështu, kode që fillojnë me "ENG ..." tregojnë që lënda zhvillohet në gjuhën angleze, me "ITA ..." në gjuhën italiane, me "ALB ..." në gjuhën shqipe, me "FRE ..." në gjuhën frënge, me "SPA ..." në gjuhën spanjolle, me "GER ..." në gjuhën gjermane. Ato që fillojnë me "TUG..." tregojnë që janë kurse karakteristike të fushës së udhërrëfimit, me "DRE..." të drejtësisë, me "GEO..." të gjeografisë, me "HIS..." të historisë, me "COM..." të komunikimit, me "CST..." të informatikës.
3. Përmbajtja tematike e kurseve, të dhënat mbi kursin, mënyrën e vlerësimit, kontrollit të dijes, literatura e detyruar etj. paraqiten në *syllabus*-et përkatëse të çdo lënde dhe shpallen në fillim të semestrit nga pedagogu përkatës.
4. Më poshtë paraqitet lista e disiplinave dhe veprimtaritë formuese të programit të shprehura të ndara në kredite për disiplinë dhe tipin e komponentit mësimor si vijon:

A. LËNDË BAZË – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme: 9 kredite

TUG 041 Teknika të udhërrëfimit turistik

Moduli 1: TUG 041-1 Teknika e parime të udhërrëfimit turistik

Moduli 2: TUG 041-2: Ndhimja e shpejtë në udhërrëfim

6 kredite

4 kredite

2 kredite

Adresa /Adress: L. Hajrro Cakëri, Rr. Sulejman Delvina, Vlorë, Albania
Tel. Fax ++35533224952

Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK

DRE 042 Legjislacion për turizmin

3 kredite

B. LËNDË KARAKTERIZUESE – përgatitje për disipinën që karakterizon programin, lëndët praktike: 32 kredite

ENG 031 Anglishte për turizmin 1 (B2)

4 kredite

ENG 032 Anglishte për turizmin 2 (C1)

4 kredite

Gjuhë e huaj 1 (*Zgjidh një nga: ITA 031 Italisht (B2)/FRE*

4 kredite

031 Frëngjisht (B2)/GER 031 Gjermanisht (B2)/SPA 031 Spanjisht (B2))

Gjuhë e huaj 2 (*Zgjidh një nga: ITA 432 Italisht (C1)/FRE*

4 kredite

432 Frëngjisht (C1)/GER 432 Gjermanisht (C1)/SPA 432

Spanjisht (C1))

GEO 050 Gjeografia e turizmit

6 kredite

Moduli 1: GEO 050-1 Gjeografi e rajonit të jugut

3 kredite

Moduli 2: GEO 050-2 Karakteristika të zhvillimit të

3 kredite

turizmit në rajonin e jugut

HIS 051 Histori e qytetërimit shqiptar

4 kredite

HIS 040 Trashëgimi natyrore e kulturore

6 kredite

Moduli 1: HIS 040-1 Trashëgimi natyrore e rajonit të jugut

3 kredite

Moduli 2: HIS 040-1 Arkeologji dhe trashëgimi kulturore e rajonit të jugut

3 kredite

C. LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE – nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje: 8 kredite

COM 052 Hyrje në komunikimin ndërkulturor

4 kredite

Zgjidh dy nga :

4 kredite

ALB 054 Etnokulturë e trevave të jugut/HIS 055 Enogastronomi e trevave të jugut

D. LËNDË PLOTËSUESE –gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale: 8 kredite

CST 046 Përdorimi i TIK në udhërrëfim

2 kredite

TUG 090 Praktikë profesionale

6 kredite

E. DETYRIME PËRMBYLLËSE: 3 kredite





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK

TUG 089 Provim përfundimtar

3 kredite

5. Për lëndën *ENG 031 Anglishte për turizmin 1 (B2)*, studenti duhet të dëshmojë zotërim të nivelit B1 në gjuhën angleze sipas Kuadrit Evropian të Përbashkët të Referencave për Gjuhët. Për përcaktimin e nivelit të gjuhës angleze, studenti do t'i nënshtrohet një testimi (*placement test*), i cili do të përgatitet e administrohet nga komisioni *ad-hoc* i pranimit të kandidatëve aplikues, i ngritur nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja. Kursi *ENG 032 Anglishte për turizmin 2 (C1)* është vazhdim i kursit *ENG 031 Anglishte për turizmin 1 (B2)*. Kursi *Gjuhë e huaj 1* është kurs me zgjedhje ku studentit i ofrohet një gjuhën e dytë për të studiuar nga këto gjuhë: italiane, frënge, spanjolle, gjermane. Për kurset *ITA 031 Italisht 1/FRE 031 Frëngjisht 1/GER 031 Gjermanisht 1/SPA 031 Spanjisht 1*, niveli hyrës i njohjes së gjuhës nga studenti është nivel fillestar. Ato synojnë përgatitjen e studentit drejt nivelit A2 sipas Kuadrit Evropian të Përbashkët të Referencave për Gjuhët. Kursi *Gjuhë e huaj 2* (*ITA 432 Italisht 2/FRE 432 Frëngjisht 2/GER 432 Gjermanisht 2/SPA 432 Spanjisht 2*) është vazhdim i kursit *Gjuhë e huaj 1* (*ITA 031 Italisht 1/FRE 031 Frëngjisht 1/GER 031 Gjermanisht 1/SPA 031 Spanjisht 1*) dhe synon përgatitjen drejt nivelit B2 në gjuhën e përzgjedhur sipas kuadrit.

Neni 4
Plani mësimor

1. Më poshtë paraqitet plani mësimor i studimit, i detajuar me semestra, me disiplinat dhe veprimtaritë formuese përkatëse të programit të shprehura të ndara në kredite, orë mësimore në auditor dhe jashtë auditorit për disiplinë si vijon:

Viti I	Semestri	Kodi	Lënda	Kredi	Tot. orë / semestër brenda & jashtë auditorit	Tot. orë / semestër në auditorit	Totali orë / javë në auditorit			Totali orë jashtë audito rit
							lex	sem	detyra	
Viti I	Sem. I	TUG 041	Teknika të udhërrëfimit turistik	6 (4+2)						
		TUG 041-1	Moduli 1: Teknika e parime të udhërrëfimit turistik	4	100	45	1	2		55
		TUG 041-2	Moduli 2: Ndihma e shpejtë në udhërrëfim	2	50	30	1	1		20
		HIS 051	Histori e qytetërimit shqiptar	4	100	45	2	1		55
		ENG 031	Anglishte për turizmin 1 (B2)	4	100	60	0	4		40
		ITA 031//FRE 031/GER 031/SPA 031	Gjuhë e huaj 1 (Zgjidh një nga: Italisht 1/ Frëngjisht 1/ Gjermanisht 1/Spanjisht 1)	4	100	60	0	4		40

Adresa /Adress: L. Hajrro Cakërri, Rr. Sulejman Delvina, Vlorë, Albania
Tel. Fax ++35533224952

Web-site: www.univlori.edu.al
e-mail: info@univlori.edu.al





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK

Sem. II	GEO 050	Gjeografia e turizmit	6 (3+3)	100	45	1	2	55
	GEO 050-1	Moduli 1: Gjeografi e rajonit të jugut	3	75	30	1	1	45
	GEO 050-2	Moduli 2: Karakteristika të zhvillimit të turizmit në rajonin e jugut	3	75	30	1	1	45
	HIS 040	Trashëgimi natyrore e kulturore	6 (3+3)					
	HIS 040-1	Trashëgimi natyrore e rajonit të jugut	3	75	30	1	1	45
	HIS 040-2	Arkeologji dhe trashëgimi kulturore e rajonit të jugut	3	75	30	1	1	45
	TOTALI		30	850	405	9	18	435
	DRE 042	Legjislacion për turizmin	3	75	30	1	1	45
	CST 046	Përdorimi i TIK në udhërrëfim	2	50	30	1	1	20
	ENG 032	Anglishte për turizmin 1 (C1)	4	100	60	0	4	40
	ITA 032//FRE 032//GER 032//SPA 032	Gjuhë e huaj 1 (Zgjidh një nga: Italisht 2/ Frëngjisht 2/ Gjermanisht 2/ Spanjisht 2)	4	100	60	0	4	40
	COM 052	Hyrje në komunikimin ndërkulturore	4	100	60	2	1	40
	ALB 054/HIS 055	Zgjidh një nga: Etnokulturë e trevave të jugut/Enogastronomi e trevave të jugut	4	100	60	2	1	40
	TUG 090	Praktikë profesionale	6	100	0	0	0	100
	TUG 089	Provim përfundimtar	3	75	0	0	0	75
	TOTALI		30	700	300	6	12	400

Neni 5

Përshkrimi i disiplinave që ngërthen programi

1. Ky program studimi ngërthen këto disiplina dhe detyrime akademike, përshkrimet e të cilave paraqiten si vijon:

- TUG 041 Teknika të udhërrëfimit turistik (Moduli 1: TUG 041-1 Teknika e parime të udhërrëfimit turistik; Moduli 2: TUG 041-2: Ndhimja e shpejtë në udhërrëfim)** - Kjo lëndë trajton konceptet bazë të teknikave të udhërrëfimit në kushtet e një industrie turistike në rritje. Lënda është konceptuar për të shërbyer si një hyrje praktike në teknikat e udhërrëfimit: njohje me profesionin e udhërrëfyesit, cilësitë që duhet të zotërojë, kodin e sjelljes, mënyrat dhe teknikat e udhërrëfimit, parimet, menaxhimin e situatave gjatë udhërrëfimit, dhënien e ndihmës së shpejtë në situata të caktuara e emergjente, itineraret, detyrat e udhërrëfyesit e çështje të tjera të lidhura me to.
- DRE 042 Legjislacion për turizmin** pasqyron zhvillimet e rëndësishme legjislative që kanë ndodhur në vendin tonë në fushën e turizmit. Vëmendje e veçantë u kushtohet çështjeve që lidhen me njohuritë për të drejtën dhe ligjin në fushën e turizmit, njësive akomoduese, agjencive turistike dhe të udhëtimit në legjislacionin shqiptar dhe atë të Bashkimit Evropian. Çështje të veçantë do t'u kushtohet Ministrisë përgjegjëse për turizmin, ATA, Unionit të operatorëve turistikë, mbrojtjes së konsumatorit turistik etj.
- ENG 031 Anglishte për turizmin 1 (B2)** - Hartimi i këtij programi orientues është bazuar tërësisht në programet e gjuhës angleze, të cilat përcaktojnë njohuritë dhe shprehjet





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE SENATI AKADEMIK

e domosdoshme gjuhësore, komunikuese dhe funksionale. Niveli i njohurive i përket nivelit B2 sipas dokumentit evropian "Kudri i Përbashkët Evropian i referencave për Gjuhët". Synon, ndër të tjera:

- Të aftësojë studentët në përdorimin e gjuhës për të komunikuar, për të përmbushur interesat e tij personale, si dhe për të plotësuar kërkesat specifike të profesionit.
- Të ndërgjegjësojë studentin për aspektet kulturore dhe të reflektojë mbi ndryshimet mes praktikave kulturore të vendit ku flitet gjuha e huaj dhe kulturës amtare duke analizuar aspekte të kulturave.
- Të zhvillojë më tej aftësinë komunikuese dhe përdorimin e njohurive gjuhësore në situata praktike të profesionit.
- Të konsolidojë bashkëveprimin ndërmjet punës në grup dhe punës së pavarur individuale dhe krijuese edhe me folës të gjuhës të cilën ai mëson.

d. **ENG 032 Anglishte për turizmin 2 (C1)** - Hartimi i këtij programi orientues është bazuar tërësisht në programet e gjuhës angleze, të cilat përcaktojnë njohuritë dhe shprehjet e domosdoshme gjuhësore, komunikuese dhe funksionale. Niveli i njohurive i përket nivelit C1 sipas dokumentit evropian "Kudri i Përbashkët Evropian i Referencave për Gjuhët". Ky program synon:

- të ngrejë në një nivel më të lartë mësimin e kësaj gjuhe, si edhe të thellojë më tej e të përafrojë të nxënit e saj më pranë vendeve anglishtfolëse. Përdorimi i metodave e praktikave bashkëkohore të mësimin të anglishtes dhe bashkërendimi i strategjive shërbejnë që studentit:
- të thellojë më tej pavarësinë dhe individualitetin intelektual dhe kulturor;
- të thellojë më tej njohuritë e marra dhe të nxisë krijimtarinë dhe mënyrën alternative të të menduarit;
- të ndërgjegjësohet për veçoritë kulturore të vendeve anglishtfolëse dhe praktikave gjuhësore në kontekste të ndryshme në turizëm.

e. **Gjuhë e huaj 1 (Zgjidh një nga: ITA 031 Italisht 1/FRE 031 Frëngjisht 1/GER 031 Gjermanisht 1/SPA 031 Spanjisht 1)** - Programi është hartuar në përputhje me Kudrin e Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët (KPERGj) dhe synon të arrijë dhe të realizojë standardet e mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit, me qëllim që t'i përgjigjet një shoqërie të hapur sipas kërkesave dhe nevojave që shtrohen përpara mësimin dhe përvetësimit të gjuhës së huaj në vendin tonë. Synimet e kursit janë:

- zhvillimi i aftësive për të folur, dëgjuar, lexuar dhe shkruar tekste të llojeve të ndryshme letrare dhe joletrare, si dhe kultivimi nëpërmjet këtyre teksteve i mendimit kritik e krijues;
- përdorimi i gjuhës dhe mjeteve të saj në varësi të situatës dhe qëllimit që kanë studentët;
- gjetja, kuptimi, analiza dhe vlerësimi informacioneve;
- respektimi i traditave dhe vlerave të kulturave të ndryshme;
- forcimi i ndërveprimit në situata reale, lidhur me tematikën e trajtuar në situatat mësimore dhe shkëmbimi i informacioneve të detajuara mbi tema që paraqesin interes për studentin;
- thellimi i njohurive gjuhësore, perceptuese dhe shprehëse, përmes të cilave studenti zgjeron njohuritë për botën dhe, në të njëjtën kohë, formohet intelektualisht.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË SENATI AKADEMIK

Kursi është i konceptuar që ta çojë studentin drejt nivelit A2 në një nga gjuhët e përzgjedhura më sipër.

f. **Gjuhë e huaj 2 (Zgjidh një nga: ITA 032 Italisht 2/FRE 032 Frëngjisht 2/GER 032 Gjermanisht 2/SPA 032 Spanjisht 2)** - Programi është hartuar në përputhje me Kuadrin e Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët (KPERGj) dhe synon të arrijë dhe të realizojë standardet e mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit, me qëllim që t'i përgjigjet një shoqërie të hapur sipas kërkesave dhe nevojave që shtrohen përpara mësimi dhe përvetësimit të gjuhës së huaj në vendin tonë. Synimet e kursit janë:

- zhvillimi i aftësive për të folur, dëgjuar, lexuar dhe shkruar tekste të llojeve të ndryshme letrare dhe joletrare, si dhe kultivimi nëpërmjet këtyre teksteve i mendimit kritik e krijues;
- përdorimi i gjuhës dhe mjeteve të saj në varësi të situatës dhe qëllimit që kanë studentët;
- gjetja, kuptimi, analiza dhe vlerësimi informacioneve;
- respektimi i traditave dhe vlerave të kulturave të ndryshme;
- forcimi i ndërveprimit në situata reale, lidhur me tematikën e trajtuar në situatat mësimore dhe shkëmbimi i informacioneve të detajuara mbi tema që paraqesin interes për studentin;
- thellimi i njohurive gjuhësore, perceptuese dhe shprehëse, përmes të cilave studenti zgjeron njohuritë për botën dhe, në të njëjtën kohë, formohet intelektualisht.

Kursi është i konceptuar që ta çojë studentin drejt nivelit B2 në një nga gjuhët e përzgjedhura më sipër.

g. **GEO 050 Gjeografia e turizmit (Moduli 1: GEO 050-1 Gjeografi e rajonit të jugut; Moduli 2: GEO 050-2 Karakteristika të zhvillimit të turizmit në rajonin e jugut)** - Turizmi është bërë këto vitet e fundit objekt studimi i shumë shkencave edhe në Shqipëri. Vend të rëndësishëm ka marrë studimi gjeografik i turizmit. Synimet kryesore rreth asimilimit të këtij programi nga studentët orientohen në:

- Ofertën turistike (bazat natyrore dhe kulturore të hapësirave gjeografike për zhvillimin e tyre turistik).
- Kërkesën turistike (format e lëvizjes turistike, prejardhja dhe struktura sociale e turistëve etj).
- Historinë e zhvillimit të turizmit.
- Nevojën parashikuese për sipërfaqe pushimi, argëtimi dhe shlodhje.
- Vendet dhe rajonet turistike (analiza cilësore e tyre, tipizimi etj).
- Rëndësinë ekonomike të turizmit.
- Mundësitë e rregullimit dhe planifikimit të hapësirës nëpërmjet turizmit.
- Analizën e shkaqeve, faktorëve dhe kushteve shoqërore për zhvillimin e turizmit.
- Përcaktimi dhe klasifikimi i rajoneve turistike.
- Analiza e hapësirave turistike model nën ndikimin e grupeve të caktuara demografike e sociale.
- Analiza e efekteve lokale dhe rajonale të turizmit.
- Analiza e ngarkesave ekologjike dhe sociale të krijuara nga turizmi.
- Studimi i elementeve bazë të zhvillimit lokal dhe rajonal të turizmit.
- Ekoturizmi, përmbajtja, parimet, përparësitë, kufizimet dhe mbrojtja.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
SENATI AKADEMIK

-Zhvillimet rajonale të turizmit në botë dhe në Shqipëri.

h. **HIS 051 Histori e qytetërimit shqiptar** synon t'u japë studentëve njohuri bazë për konceptin e 'qytetërimit shqiptar'. Fillimisht ai do të trajtohet nga pikëpamja teorike dhe pastaj do të synohet që koncepti i 'qytetërimit shqiptar' të shtjellohet edhe si ligjërime dhe i lidhur ngushtë me atë që shihet si 'identiteti kombëtar'. Mendojmë se një qasje e tillë do t'u japë studentëve mundësinë ta shohin qytetërimin shqiptar si një dukuri të lëvizshme, që nuk është statike, por që është gjithmonë në një proces formulimi dhe riformulimi. Nga ana tjetër, një qasje e tillë do të mund të tregojë se ajo që shpesh përfytyrohet si 'qytetërim shqiptar' i dhënë një herë e përgjithmonë është në të vërtetë produkt i shtresëzimeve kulturore të ndryshme që vijnë përgjatë shekujve.

i. **HIS 040 Trashëgimi natyrore e kulturore (Moduli 1: HIS 040-1 Trashëgimi natyrore e rajonit të jugut; Moduli 2: HIS 040-1 Arkeologji dhe trashëgimi kulturore e rajonit të jugut)** - Kursi është konceptuar si një kurs hyrës, i ndarë në dy module, për studentët e këtij programi, të cilët njihen për herë të parë me këtë lëndë. Në këtë kurs, do të trajtohen çështje që kanë të bëjnë me pasuritë natyrore, kulturore dhe trashëgimore të popullit shqiptar, arkeologjinë, parë në kontekstin e turizmit dhe asaj që është tërheqëse dhe ngjall interes tek turistët dhe vizitorët e huaj, por jo vetëm. Ky kurs do t'i aftësojë studentët që të:

- mendojnë në mënyrë kritike për historinë, qytetërimin, kulturen dhe artin shqiptar.
- identifikojnë qasjet dhe veçoritë karakteristike të trashëgimisë natyrore e kulturore shqiptare.
- kultivojnë shijen dhe gjykimin për objekte të trashëgimisë natyrore e kulturore shqiptare.
- të kuptojnë fillesat e zhvillimeve kulturore dhe historike shqiptare.

j. **COM 052 Hyrje në komunikimin ndërkulturor** është konceptuar si një kurs hyrës për studentët e këtij programi, të cilët njihen për herë të parë me këtë lëndë. Në këtë kurs, do të trajtohen çështje që kanë të bëjnë me ndërveprimin e njerëzve nga sfonde të ndryshme kulturore dhe gjuhësore, sidomos në një kontekst të gjerë e të diversifikuar të shenjuar nga zhvillimet e teknologjisë, globalizimi dhe lëvizjet migratore. Të rinjtë gjithnjë e më shumë zgjedhin të studiojnë në një vend të ndryshëm nga i tyri, ndër të tjera edhe për të marrë një përvojë të re kulturore. Në këto kushte, nevoja për përshtatje dhe ndërtim të marrëdhënieve ndërkulturore bëhet edhe më e madhe. Ky kurs jep shprehje bazë të të kuptuarit të kompleksitetit të komunikimit gjuhësor dhe ndërkulturor në vendndodhje të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Rrit ndërgjegjësimin për domethënien që merr anglishtja si lingua franca në një botë gjithnjë edhe më të globalizuar dhe të ndërlidhur, si dhe nënvizon rëndësinë e njohjes së gjuhëve të tjera në këto kushte. Në këtë kurs paraqiten koncepte bazë të komunikimit ndërkulturor, duke vënë theksin tek zhvillimet historike në këtë fushë.

k. **ALB 054 Etnokulturë e trevave të jugut** është një kurs i projektuar për studentët e këtij programi, i cili synon t'i njohë ata me elementet kryesore të etnokulturës së pasur të trevave të jugut që paraqesin interes për vizitorët vendas e të huaj. Në këtë kurs, studenti do të marrë njohuri rreth traditave e zakoneve të trevave të jugut, veshjet, festimet, këngët, vallet, folklorit etj.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE SENATI AKADEMIK

l. HIS 055 Enogastronomi e trevave të jugut është konceptuar si një kurs hyrës për studentët e këtij programi, të cilët njihen për herë të parë me këtë lëndë, e cila studion raportet mes territorit dhe veprimtarive njerëzore që lidhen me produktet e tokës, kryesisht ushqime dhe pije. Në këtë kurs, do të trajtohen çështje që kanë të bëjnë me traditat kulinare, gastronomike e traditat e prodhimit, shijimit e vlerësimit të pijeve tradicionale të trevave të jugut.

m. CST 046 Përdorimi i TIK në udhërrëfim - Në këtë kurs synohet të jepen njohuri mbi teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit në turizëm dhe komunikim për qëllime turistike në mënyrë që studentët të fitojnë njohje dhe kompetenca përdorimi të TIK në procesin e promovimit të turizmit dhe ofrimit të shërbimeve në turizëm për ta bërë atë sa më efektiv. Lënda do të synojë në mënyrë specifike të aftësojë studentin që të integrojë mjetet kryesore që ofron TIK në komunikimin për qëllime turistike, si p.sh. mediet sociale, blogjet, faqet web etj.

n. TUG 090 Praktikë profesionale - Programi që zhvillohet nëpërmjet lëndës "Praktikë profesionale" paraqet interes për studentët e programit, pasi do të konkretizojnë, prekin, perceptojnë gjithë njohuritë e tyre teorike rreth potencialeve turistike (natyrore dhe kulturore) të vendit tonë. Shqipëria, vend me pasuri të shumta natyrore e kulturore-historike. Ndërtim gjeologjik i larmishëm, klimë e shumëllojshme dhe hidrografi e pasur, botë bimore dhe shtazore e shumëllojshme (zona me status të ndryshëm mbrojtjeje, sipas IUCN). Ofertë e larmishme turistike (arkeologjike, etnografike, historike, fetare etj.). Praktika mësimore e studimit në terren ka si qëllim dhe synim të pajisë studentët me njohuri të drejtpërdrejta të veçorive natyrore dhe historik-kulturore të hapësirave gjeografike të përcaktuara, si dhe tregues e dëshmi të përvojës më të rëndësishme historike e politiko-kulturore të periudhave të ndryshme historike në vendin tonë. Synimet kryesore rreth asimilimit të këtij programi nga studentët orientohen në:

-Ofertën turistike (bazat natyrore dhe kulturore të hapësirave gjeografike për zhvillimin e tyre turistik).

-Zonat më tipike natyrore me potenciale turistike dhe ato historiko-kulturore.

-Zonat me status të ndryshëm mbrojtjeje (njohja, studimi, mbrojtja, problematikat që hasim, mundësitë për zhvillimin e turizmit).

o. TUG 089 Provim përfundimtar - Studentët diplomohen me provim të përgjithshëm. Provimi i përgjithshëm realizohet me shkrim dhe me gojë. Provimi me shkrim teston nivelin gjuhësor të studentit (C1) përmes ushtrimeve gjuhësore (gramatikore dhe leksikore) dhe aftësinë e të mendurit kritik dhe argumentimit përmes leximit dhe shkrimit duke u paraqitur atyre tekste turistike dhe situata profesionale të udhërrëfimit për të shtjelluar. Provimi me gojë ndërtohet në formën e intervistës me pyetje nga disiplina themelore në programin e studimit. Vlerësimi përfundimtar përftohet nga mesatarja e të dy vlerësimeve bashkë.

Neni 6

Format dhe organizimi i studimit të programit me karakter profesional:





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE SENATI AKADEMIK

“Udhërrëfyes turistik për rajonin e jugut”

1. Veprimtaritë formuese që karakterizojnë programin e studimit ndahen në:
 - a. mësim në auditor që përfshin: leksione, seminare, forma të kontrollit të vazhdueshëm të dijeve, seanca të praktikave profesionale;
 - b. studim individual që përfshin: studim, punim relacionesh, detyrash apo projektesh;
 - c. përgatitje për provime, të pjesshme e përfundimtare;
 - d. përgatitje për provimin e formimit;
 - e. praktika profesionale, praktika në terren.

Neni 7

Format e kontrollit të dijes


1. Programi mësimor i programit me karakter profesional: “Udhërrëfyes turistik për rajonin e jugut” parashikon provime të pjesshme, vlerësime vjetore, provime përfundimtare të lëndëve mësimore dhe të provimit të formimit.
2. Format e kontrollit të dijeve përfshijnë vlerësimin vjetor, i cili përmbledh detyrat e kursit, projektet, esetë; provimet e pjesshme; provimet përfundimtare; provimin e formimit.
3. Kreditet korresponduese për çdo veprimtari formuese fitohen nga studentët vetëm për vlerësim pozitiv në verifikimin përfundimtar të dijeve të fituara prej tyre. Për verifikimin e dijeve përdoren forma të ndryshme që kombinojnë verifikimin e vazhdueshëm (provimet e pjesshme, projektet/detyrat e kursit) me atë përfundimtar (provimin final).
5. Kontrolli i dijes së një lënde (provimi) përcaktohet nga titullari i lëndës dhe mund të bëhet:
 - a) me shkrim,
 - b) me gojë,
 - c) i kombinuar, me shkrim e me gojë,duke u mbështetur në programin mësimor. Vlerësimi përfundimtar i modulit bëhet ose vetëm përmes një provimi përfundimtar, ose përmes një provimi të pjesshëm, një provimi përfundimtar dhe/ose kërkesave specifike që vendos çdo pedagog për lëndën në syllabus. Për modulet e koordinuara (ndarje brenda një lëndë) bëhet ose vlerësim kolegjal i studentit në bazë të përqindjes së pikëve që ai ka grumbulluar në vlerësimet e secilës prej pjesëve përbërëse të modulit, ose vlerësim i mëvetësishëm për secilin modul sipas përcaktimeve paraprake në programin lëndor.
6. Tezat e provimit, në të gjitha rastet e kontrollit, hartohen dhe firmosen nga titullari i lëndës. Kompromentimi i tezës është përgjegjësi direkte e pedagogut.

Neni 8

Kushtet për t’u konsideruar kalues në një lëndë

1. Shkalla e përvetësimit të programit lëndor vlerësohet me sistemin prej dhjetë notash, 1, ..., 10. Notat nga pesë e lart janë kaluese.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE SENATI AKADEMIK

2. Në format e kontrollit me shkrim (provime, detyra/projekte kursi) përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, detyrimsht, konvertohet në notë. Në vlerësimin final të lëndës, pedagogu përkatës përcakton edhe peshën e vlerësimit të punës së pavarur të studentit (detyrave/projekteve të kursit).
3. Normat e konvertimit në notë të pikëve të grumbulluara përcaktohen nga pedagogët përkatës në çdo program lëndor (*syllabus*), por minimumi i përqindjes së pikëve të grumbulluara për marrjen e një vlerësimi pozitiv (me notë 5) është $\geq 40\%$ në të gjitha modulet. Ulja e këtij kufiri mund të bëhet pas daljes së rezultateve të të gjithë grupit, me propozim të pedagogut të lëndës dhe miratim të përgjegjësit të departamentit, kur kjo është e justifikuar dhe e argumentuar.
4. Për modulet e integruara (që përmban një lëndë), në rast se është parashikuar në programin lëndor, bëhet vlerësimi kolegjial i studentit në bazë të shumës së përqindjes së pikëve që ai ka grumbulluar në vlerësimet e secilës prej pjesëve përbërëse të modulit. Për të marrë një vlerësim pozitiv përfundimtar, studentit duhet të ketë grumbulluar $\geq 40\%$ jo vetëm të totalit të modulit, por edhe të pikëve përkatëse të çdo lënde përbërëse të modulit të integruar. Në rast se është parashikuar ndryshe, kryhet vlerësim përkatës i studentit për çdo modul të lëndës.

Neni 9

Procedurat e testimit dhe apelimit të rezultateve të testimit nga ana e studentëve

1. Procedura e kontrollit të dijeve është si më poshtë:
 - a. Kontrolli i njohurive bëhet në një nga këto mënyra: 1. vetëm me një provim final dhe me anë të detyrave; 2. me një provim të pjesshëm dhe një provim final, si dhe me anë të detyrave të kursit.
 - b. Provimet mund të realizohen me shkrim ose me gojë.
 - c. Mënyrat e kontrollit të dijes parashikohen në programin lëndor dhe i bëhen të ditura studentit paraprakisht në fillim të semestrit.
 - d. Pas 48 orësh brenda kryerjes së kontrollit të njohurive (me gojë ose me shkrim), pedagogu njofton studentët për rezultatin e vlerësimit në provim. Ky afat mund të tejkalohet deri në 72 orë në rastet kur pedagogu i lëndës ka zhvilluar më shumë se një provim në një ditë.
2. Studenti ka të drejtë të shikojë fletën e tij të provimit individualisht.
3. N.q.s është i paqartë ose nuk është dakord me vlerësimin që ka marrë, ka të drejtë të kërkojë sqarime nga pedagogu përkatës.
4. N.q.s studentit është i paqartë ose nuk bindet për rezultatin e provimit, paraqet një kërkesë me shkrim pranë sekretarisë së departamentit.
5. Në bazë të kësaj kërkesë, departamenti ngre një komision apelimi *ad hoc* për vlerësimin e kërkesës së studentit. Komisioni duhet të bëjë rivlerësimin e provimit të studentit dhe duhet të japë përgjigje brenda tri ditëve nga çasti i paraqitjes së kërkesës për rivlerësim.
6. Pikët përfundimtare të testimit janë ato të vendosura nga komisioni i apelimit.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE SENATI AKADEMIK

Neni 10

Orari i studimit dhe provimeve

1. Koha dhe auditori i zhvillimit të mësimit përcaktohet në orarin e shpallur nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja. Orari duhet të respektohet plotësisht nga të gjithë studentët dhe mësime të mësimit.
2. Orari i përgjithshëm i universitetit duhet të shpallet të paktën 3 javë përpara fillimit të semestrit. Orari i provimeve finale duhet të shpallet jo më vonë se 3 javë nga mbarimi i semestrit.
3. Orari duhet të përmbajë: kodin dhe emërtimin e lëndës, orarin, sallën ku do të kryhet mësimi/provimi dhe emrin e pedagogut përkatës.

Neni 11

Detyrimet e mundshme që lidhen me frekuentimin

1. Frekuentimi i leksioneve është i detyrueshëm në masën 75%.
2. Frekuentimi i seminareve është i detyrueshëm në masën 75%.

Neni 12

Karakteristikat e detyrave/projekteve të kursit

1. Detyrat dhe projektet e kursit mund të jenë disa lloje: ese, raport, hartim itinerari, projekt/punë prezantuese, poster etj.
2. Kërkesat për mënyrën e organizimit të detyrës, përmbajtjen, mënyrën e paraqitjes së punimit, përgatitjen teknike të tij/saj përcaktohen nga pedagogu përkatës.

Neni 13

Detyrimet përmbyllëse

1. Studentët përmbyllin studimet me provim të përgjithshëm.
2. Provimi i përgjithshëm i formimit është një provim përmbyllës që jepet nga studenti vetëm pasi ka përmbushur të gjitha detyrimet e tjera akademike për plotësimin e programit të studimit.
3. Provimi i përgjithshëm realizohet me shkrim dhe me gojë.
4. Provimi me shkrim teston nivelin gjuhësor, në gjuhën angleze për turizëm në nivelin (C1), dhe në gjuhën e dytë të zgjedhur në nivelin B2, atë kulturor e ndërkulturor të studentit përmes ushtrimeve të larmishme për të shquar aftësinë e të mendurit kritik dhe argumentimit përmes leximit dhe shkrimit.
5. Provimi me gojë ndërtohet në formën e intervistës me pyetje nga disiplina themelore në programin e studimit.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE SENATI AKADEMIK

6. Vlerësimi përfundimtar përftohet nga mesatarja e të dy vlerësimeve të marra së bashku. Provimi me shkrim dhe ai me gojë do të zënë 50% të vlerësimit secili.

Neni 14

Modalitetet për dhënien e certifikatës

1. Në përfundim të kursit të plotë të studimeve, studentëve iu lëshohet “Certifikatë profesionale”. Kërkesat për fitimin e certifikatës në programin programit me karakter profesional “Udhërrëfyes turistik për rajonin e jugut” janë:

a. Studenti duhet të jetë vlerësuar pozitivisht në të gjitha modulet e detyrueshme në disiplinat:

- e formimit bazë (2)
- karakterizues (6)
- ndërdisiplinore/integruese (4)
- plotësuese (2)

b. Studenti duhet të ketë vlerësim ‘kalues’ në provimin e formimit.

c. Në përfundim të studimeve të ketë grumbulluar të 60 ECTS (kredite).

d. Pasi ka shlyer të gjitha detyrimet akademike dhe financiare, studenti paraqitet pranë sekretarisë mesimore të DGJH-së për të kryer procedurat përkatëse.

Neni 15

Shkeljet e integritetit akademik

1. Të gjithë anëtarët e komunitetit akademik duhet të praktikojnë dhe të ruajnë standardet e integritetit akademik dhe ndershmërisë. Integritet akademik do të thotë të paraqesësh vetveten dhe punën tënde me ndershmëri. Prezantimi i keq i vetvetes dhe punës është mashtrim, sepse do të thotë që studentët pretendojnë kredite për ide apo punë që nuk janë në të vërtetë vepër e tyre. Më poshtë janë disa shembuj pandershmërie akademike:

a. Mashtrim në provime, që përfshin përdorimin e materialeve si libra dhe/ose shënime në mënyrë të paautorizuar nga pedagogu, kopjimin nga testimi apo detyra e dikujt tjetër, dhënien e ndihmës dikujt tjetër të kopjojë punën, zëvendësimin e punës së dikujt tjetër me punën tënde, kopjimi në provime, ose të tjera forma shkeljesh në sjellje gjatë provimeve.

b. Plagjiaturë e punës së të tjerëve. Plagjiaturë do të thotë të përdorësh punën ose idetë e dikujt tjetër pa i dhënë atij personi kredit për punën e vet; duke bërë këtë, studentët pretendojnë kredit për mendimin e dikujt tjetër. Studentët duhet të dokumentojnë gjithmonë burimin e informacionit qoftë atëherë kur e kanë lexuar edhe atëherë kur e kanë dëgjuar. Kur punohet me burime të shkruara, një dallim i qartë duhet bërë midis thonjzave (të cilat riprodhojnë informacionin fjalë për fjalë nga burimi dhe e vendosin atë midis thonjzave) dhe perifrashimeve (të cilat e përpunojnë burimin e informacionit dhe e paraqesin atë me fjalët e studentit). Qoftë citimet midis thonjzave, qoftë perifrashimet duhen të dokumentohen në çdo rast. Edhe në rastin kur studentët rishprehin, përmbledhin apo përzgjedhin pjesë nga puna





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË SENATI AKADEMIK

e tjetrit, idetë i përkasin në çdo rast personit tjetër, dhe mosdhënia e kreditit ndaj punës së tij përbën prezantim të keq të punës aktuale të studentit dhe plagjiaturë të ideve të dikujt tjetër. Të blësh një detyrë kursi ose të përdorësh informacion nga Rrjeti Ndërkombëtar i Informacionit ose Interneti pa njohur burimin dhe ta dorëzosh atë si punë vetjake është plagjiaturë.

c. Falsifikimi i dokumenteve apo paraqitja dizinformuese e kredencialeve të një personi është shkelje.

d. Bashkëpunimi i paautorizuar në detyra kompjuterike dhe hyrje e paautorizuar dhe përdorimi i programeve kompjuterikë duke përfshirë modifikimin e skedarë kompjuterikë të krijuar nga të tjerë dhe paraqitjen si punë tënden është shkelje. Me përjashtim të rasteve kur japin udhëzime specifike, në të gjitha rastet, pedagogët presin prej studentëve punë individuale pa ndihmën e të tjerëve në detyra kursi, provime, raporte laboratorit dhe ushtrime kompjuterike, si dhe dokumentacion të të gjitha burimeve në rastet kur këto vihen në përdorim.

Neni 16 Dispozita të veçanta

1. Departamenti i Gjuhëve të Huaja dhe njësitë e tjera bashkëpunuese në këtë program kanë të drejtën dhe detyrimin e rishikimit periodik të kësaj rregulloreje, sidomos përsa i përket numrit të krediteve që i jepen çdo disipline të veçantë mësimore ose veprimtarie tjetër formuese.

